



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:088015
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05713809

Pml.nr.249/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Mejreme Memaj, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit B. Rr., nga fshati ..., komuna e P., për shkak veprës penale “Ushtrimi i ndikimit”, nga neni 431, paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.50/2022 të datës 14.06.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.517/2023 të datës 05.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 15.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit B.Rr., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.517/2023 i datës 05.10.2023 dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.50/2022 të datës 14.06.2023, të dënuarin B. Rr., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale “Ushtrimi i ndikimit”, nga neni 431, paragrafi 1 të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej dymijë (2.000) euro, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, ndërsa nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë dënimin me gjobë, atëherë gjykata do t'ia

zëvendëson dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që një (1) ditë e dënimit me burgim do të barazohet me njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë.

Koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 21.02.2019 deri më datën 21.05.2019, të dënuarit B. Rr., do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë.

Ndaj të dënuarit B. Rr., është shqiptuar edhe dënimi plotësues ndalimi i ushtrimit të profesionit në institucionet publike në kohëzgjatje prej një (1) viti, duke e llogaritur nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Është vendosur që telefoni i markës “*Samsung*” t'i kthehet të dënuarit, kurse është konfiskuar shumta e të hollave prej dhjetë (10) eurove.

I dëmtuari A. S., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Është detyruar i dënuari B. Rr., që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëqind (100) euro dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.517/2023 e datës 05.10.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit B. Rr., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit B. Rr., avokati Ahmet Gjinovci, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. lidhur me nenin 38, paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t'i anulon aktgjykimet e lartcekura, duke e kthyer çështjen në rigjykim.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.nr.139/2024 e datës 24.04.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit B. Rr., të aprovohet si e bazuar, duke konsideruar se në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. lidhur me nenin 38, paragrafi 2 të KPP-së, pasi që në këtë çështje penale, në përbërje të kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë ka marrë pjesë gjyqtari Z. H., i cili gjithashtu si gjyqtar i gjykatës së shkallës së parë, dy herë radhazi ka marrë pjesë si kryetar i trupit gjykues në aktgjykimet PKR.nr.58/2019, të datës 16.10.2019 dhe PKR.nr.54/2020, të datës 28.10.2020.

Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, si dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe përgjigjen në kërkesë të Kryeprokurorit të Shtetit, gjeti se:

- kërkesa është e bazuar.

Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, përveç pretendimeve tjera, mbrojtësi i të dënuarit B. Rr. thekson se aktgjyrimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë me shkelje esenciale

të dispozitave të procedurës penale, të theksuara më lart, pasi që pjesë përbërëse e kolegjit të kësaj gjykate ka qenë edhe gjyqtari Z. H., i cili si gjyqtar i gjykatës së shkallës së parë, e ka gjykuar dy herë këtë çështje penale në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit, e duke mos u lëshuar në shqyrtimin e pretendimeve tjera të cekura në kërkesë, gjen se qëndron fakti se gjyqtari Z.H., nuk është dashur që të jetë anëtarë i kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë, pasi që i njëjti si gjyqtar i gjykatës së shkallës së parë, e ka gjykuar dy herë këtë çështje penale në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues. Kjo nga fakti se me dispozitën e nenit 39, paragrafi 2 të KPP-së, është parashikuar se “Gjyqtari përjashtohet si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtari i kolegjit të apelit apo kolegjit të Gjykatës Supreme nëse ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal. Megjithatë, gjyqtari nuk përjashtohet kur ai ose ajo ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale si anëtar i kolegjit shqyrtues”. Rrjedhimisht, sipas dispozitës së paragrafit 2, të nenit 39 të KPP-së, gjyqtari përjashtohet në rastet kur ka marrë pjesë në procedurat e mëparshme në të njëjtin rast penal, siç është situata me rastin konkret, ku gjyqtari në fjalë, i cili kishte qenë pjesë përbërëse e kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë, kishte qenë paraprakisht dy herë kryetar i trupit gjykues në gjykatën e shkallës së parë, pasi që kjo çështje penale ishte kthyer në rigjykim.

Në këtë mënyrë, Gjykata Supreme e Kosovës duke u nisur nga ky fakt e duke mos u lëshuar në shqyrtimin e pretendimeve tjera, meqenëse përbërja e gjykatës së shkallës së dytë nuk ka qenë në pajtim me ligjin dhe se në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili nuk kanë mundur të jenë pjesë e kolegjit, konstaton se në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. të KPP-së, e cila shkelje për shkak të natyrës së saj, detyrimisht e ka kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të shkallës së dytë dhe kthimin e kësaj çështje në rigjykim në këtë gjykatë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së dytë duhet të mënjanojë shkeljen e cekur dhe pasi që të vlerësojë pretendimet ankimore, të vendos në mënyrë meritore.

Duke u bazuar në këto që u theksuan më lart dhe në kuptim të nenit 438, paragrafi 1, nën-paragrafi 2 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.249/2024, më datë 15.05.2024

Procesmbajtëse,
Qefsere Berisha

Kryetar i kolegjit,
Rasim Rasimi